




MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Gjakovë me datë 26.03.2018 në mes të :

1. OJQ “Jakova Innovation Center” në Gjakovë të cilën e përfaqëson Drejtor Ekzekutiv z. Fatos Axhemi, në tekstin vijues: “Jakova Innovation Center”
2. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Gjakovës Ardian Gjini, në tekstin vijues: Komuna

Neni 1 Qëllimi

Komuna e Gjakovës ka për qëllim kryesor që për mes subvencionimit të lehtësojë punën e “Jakova Innovation Center”, duke i ofruar kësaj qendre përkrahje financiarë në vlerë prej 3,000.00€ që me këto fondet të krijojë kushte më të mira për bizneset e reja dhe ndërmarrësit e rinj dhe zhvillimin e vetë “Jakova Innovation Center”,

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

“Jakova Innovation Center” dhe Komuna do të bashkëpunojnë për realizimin e projekteve të vazhdueshme me qëllim të përkrahjes së bizneseve të reja në Komunën e Gjakovës dhe krijimit të një ambienti më të favorshëm të të bërit biznes si dhe do të sigurojnë bashkëpunim dhe përkrahje reciproke në projektet dhe detyrat e përbashkëta që lidhen me sektorin e biznesit, në veçanti për përkrahjen e bizneseve të reja më qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik në Komunën e Gjakovës.

Neni 3

Objektivat e Marrëveshjes

Objektivat e marrëveshjes dhe parimet e bashkëpunimit në mes palëve janë:

- Bashkëpunim në fushën e përkrahjes së bizneseve të reja në Komunën e Gjakovës, duke shkëmbyer informata dhe të dhëna mbi gjendjen aktuale të sektorit të biznesit dhe NVM-ve në Komunën e Gjakovës,
- Ofrit të përkrahjes komplementare në mes të dy organizmave - me qëllim krijimit të një klime më të mirë të bërit biznes dhe zhvillimit të sektorit të NMVM.
- Në kuadër të bashkëpunimit të ofrojmë ndihmë bizneseve/ndërmarrësve që startojnë duke u ndihmuar atyre që të mbijetojnë dhe të rriten gjatë periudhës së fillimit kur ato janë më të ndjeshme. Bashkëpunimi në zhvillimin dhe përkrahjen e bizneseve të reja duke ofruar hapësirë pune me inventar në Qendrën Inovative me qëllim të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së bizneseve të reja, duke siguruar një asistencë administrative, shërbime përkrahëse teknike dhe qasje në grante që ofrohen për bizneset e reja.
- Bashkëpunim dhe asistencë në zhvillimin e projekteve të përbashkëta me komunën që lidhen me fushën e të bërit biznes.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e palëve

Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe detyrimeve të kësaj marrëveshje. Për këtë që u tha më lart, të dy palët pajtohen si në vijim:

- Komuna ka të drejtë të kontrollojë dhe verifikojë shpenzimet që lidhen më përkrahjen financiare respektivë;
- “Jakova Innovation Center” duhet të raportojë për të gjitha këto shpenzime duke i dërguar raport përmbledhës për periudha të rregullta në organet e administratës komunale;
- “Jakova Innovation Center” duhet të jetë racionale në shpenzimin e këtyre shërbimeve të mbështetura nga Komuna e Gjakovës;
- Në bazë të kësaj mbështetje nga Komuna, Jakova Innovation Center do të ofrojë shfrytëzimin e hapësirave të qendrës për aktivitetet e Komunës së Gjakovës pa pagesë;
- Palët janë të obliguara të organizojnë dhe marrin pjesë në grupe vlerësimi të përbashkëta;
- Palët, gjatë gjithë kohës, duhet të punojnë në nxitjen e qëndrueshmërisë e kësaj qendre, përmes hulumtimit të mundësive të mëtejshme për rritjen e mjeteve nga donatorët potencial.

Neni 5
Kohëzgjatja e projektit


Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e të dyja palëve dhe mbaron me përmbushjen e obligimeve. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet me pajtimin e të dy palëve nënshkruese, ndërsa konfliktet eventuale lidhur me objektin, qëllimin apo obligimet e palëve të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve nënshkruese.

Neni 6

Kjo Marrëveshje është përpiluar në 3 kopje identike dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën kur nënshkruhet nga personat e autorizuar .

PALET


Jakova Innovation Center (JIC)



Fatos Axhemi



Komuna e Gjakovës



Ardian Gjini